

20231542752

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË NDJEKJES SË KOMUNIKIMEVE

Neni 1

Në Ligjin e Ndjekjes së Komunikimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 71/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 108/19) në nenin 35, paragrafi (2), fjalët: “Këshilli i Kontrollit Civil” zëvendësohen me fjalët: “Këshilli i Mbikëqyrjes Civile”.

Neni 2

Në nenin 39, në paragrafin (2) shtohet fjali e re si më poshtë:

“Komisioni e njofton kryetarin e Kuvendit dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit për zgjedhjen e dy ekspertëve për mbështetje të përhershme dhe për zgjedhjen e ekspertëve shtesë nacionalë ose ndërkombëtarë.”.

Pas paragrafit (2), shtohen pesë paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6) dhe (7), si më poshtë:

“(3) Me ekspertët teknikë për mbështetje të përhershme nga paragrafi (2) i këtij neni, Kuvendi lidhë marrëveshje në bazë të së cilës u takon kompensim mujor në shumën bruto prej një rroge mesatare të paguar neto për punëtor në Republikë, të publikuar deri në ditën e pagesës.

(4) Ekspertëve teknikë për mbështetje të përhershme nuk u paguhet kompensimi i paragrafit (3) të këtij neni për muajin në të cilin nuk janë angazhuar.

(5) Për kryerjen e punëve për të cilat janë angazhuar nga Komisioni i nenit 38 të këtij ligji, ekspertët teknikë të paragrafit (2) të këtij neni, të cilët jetojnë jashtë qytetit të Shkupit, kanë edhe të drejtë kompensimi të shpenzimeve të udhëtimit në lartësinë e çmimit të biletës për shfrytëzimin e transportit publik.

(6) Me ekspertët shtesë nacionalë ose ndërkombëtarë të paragrafit (2) të këtij neni, nëse është e nevojshme, me propozim të Komisionit të nenit 38 të këtij ligji, Kuvendi lidh marrëveshje angazhimi, në të cilën, varësisht nga kushtet dhe vëllimi i angazhimit, mund t'u caktohet kompensim monetar që nuk mund të jetë më i lartë se shumata e dyfishtë e pagës mesatare neto të paguar për punëtor në Republikë, të publikuar deri në ditën e pagesës.

(7) Kompensimet e paragrafëve (3), (5) dhe (6) të këtij neni paguhet nga Buxheti i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.”.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (8).

Neni 3

Neni 46 ndryshon si më poshtë:

“Komisioni, për punën e tij miraton Rregullore, e cila rregullon çështjet e mënyrës së punës së Komisionit, mënyrën e punësimit të ekspertëve teknikë dhe mënyrën dhe procedurat e kryerjes së mbikëqyrjes së masave për ndjekjen e komunikimeve në përputhje me ligjin.”.

Neni 4

Në titullin para nenit 47, fjala "Emërim" zëvendësohet me fjalën "Zgjedhje"

Neni 5

Në nenin 47 fjala “emëron” zëvendësohet me fjalën “zgjedh”.

Neni 6

Në nenin 48 paragrafi (1) fjala “emëron” zëvendësohet me fjalën “zgjedh”.

Në paragrafin (2) fjala “emërim” zëvendësohet me fjalën “zgjedhje”.

Në paragrafin 3 alineja (4) ndryshohet si më poshtë:

“- të ketë përvojë pune prej të paktën pesë vjetësh në sferën e drejtësisë, të telekomunikimeve dhe teknologjive informatike, të sigurisë dhe mbrojtjes ose pesë vjet përvojë pune në organizata joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të sigurisë dhe mbrojtjes.”.

Pas paragrafit 3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6) si më poshtë:

“(4) Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit u takon kompensim monetar mujor që paguhet nga Buxheti i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Kompensimin mujor i paragrafit (4) të këtij neni, në shumën bruto, e përcakton Komisioni i Çështjeve të Zgjedhjeve dhe të Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk mund të jetë më i madh se shumata e dyfishtë e rrogës mesatare të paguar neto për punëtor në Republikë e publikuar deri në ditën e pagesës.

(6) Për praninë në seancë të Këshillit, kryetarit, përkatësisht anëtarit të Këshillit, i cili jeton jashtë qytetit të Shkupit, i takon edhe kompensimi i shpenzimeve rrugore në lartësinë e përcaktuar në nenin 39, paragrafi (5) të këtij ligji.”.

Neni 7

Pas nenit 48 shtohet nen i ri 48-a si më poshtë:

“Neni 48-a

1) Këshilli ka vulë dhe vulë katrore.

(2) Vula dhe/ose vula katrore vendosen në materialet dhe dokumentet që Këshilli i pranon, i miraton ose i udhëzon, për kryerjen e kompetencës së tij të përcaktuar me ligj.

(3) Mënyra e pranimi, e procedimit dhe e ruajtjes së dokumenteve të Këshillit bëhet në përputhje me ligjin dhe rregullohet me Rregulloren e Këshillit.”.

Neni 8

Neni 51 ndryshon si më poshtë:

“Këshilli vepron me nismë të tij ose pas parashtresës së paraqitur nga qytetari.”.

Neni 9

Pas nenit 51 shtohen dy nene të reja, neni 51-a dhe 51- b, si më poshtë:

“Neni 51-a

(1) Këshilli bën mbikëqyrjen me nismë të vet, me njoftim paraprak në ATO dhe tek organet e autorizuar, me ç’rast e njofton Komisionin e nenit 38 të këtij ligji. Mbikëqyrja bëhet me qëllim të krahasimit të të dhënave nga mostrat e anonimizuar të urdhëresave për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, për periudhën e tre muajve të fundit.

(2) Këshilli, gjatë mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni, konstaton nëse ka shmangie dhe/ose parregullsi gjatë krahasimit të të dhënave.

(3) Në rast se Këshilli konstaton shmangie dhe/ose parregullsi gjatë krahasimit të të dhënave, menjëherë e njofton prokurorin publik kompetent dhe Komisionin.

(4) Këshilli e informon publikun për mbikëqyrjen e kryer me nismë të tij pa paraqitur të dhëna konkrete dhe duke mbajtur llogari për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 51-b

(1) Pas parashtresës së qytetarit, Këshilli, bën mbikëqyrjen në mënyrë të pavarur me qëllim krahasimin e të dhënave nga mostrat e anonimizuar të urdhëresave për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, për periudhën e tre muajve të fundit.

(2) Pas parashtresës së qytetarit, Këshilli, sipas nevojës, drejtuar Komisionit të nenit 38 të këtij ligji mund t'i parashtrorë kërkesë për angazhim të ekspertëve për mbështetje të përhershme për zbatimin e mbikëqyrjes profesionale.

(3) Në bazë të kërkesës së paragrafit (2) të këtij neni, Komisioni angazhon ekspertë për mbështetje të përhershme.

(4) Pas mbikëqyrjes së kryer, ekspertët për mbështetje të përhershme në afat prej 48 orëve dorëzojnë njoftim në Këshill dhe e informojnë Komisionin.

(5) Në mungesë ose pamundësi të angazhimit të ekspertëve për mbështetje të përhershme, dhe në bazë të kërkesës së paragrafit (2) të këtij neni, Komisioni mund të kryejë mbikëqyrjen sipas nenit 40 të këtij ligji në mënyrë të pavarur ose së bashku me Këshillin.

(6) Në bazë të njoftimit nga paragrafi (4) i këtij neni dhe mbikëqyrjes së kryer në mënyrë të pavarur, Këshilli për rastin konkret sa më shpejt që të jetë e mundur do ta njoftojë parashtresin e parashtresës se

- është konstatuar keqpërdorim ose
- nuk është konstatuar keqpërdorim.

(7) Nëse Këshilli konstaton keqpërdorim, menjëherë e njofton prokurorin publik kompetent dhe Komisionin.

(8) Këshilli, pa paraqitur të dhëna konkrete për rastin dhe duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave personale, e informon publikun . ".

Neni 10

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Kushtet e punës së Këshillit i siguron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Mjetet financiare për punën e Këshillit sigurohen në Buxhetin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Nëpunësi i Kuvendit i caktuar për kryerjen e punëve profesionale për nevojat e Këshillit ka të drejtë të kompensimit të posaçëm që nuk mund të jetë më i lartë se 30% e shumës së pagës bazë të nëpunësit të Kuvendit në pozitën për të cilën është sistemuar në Shërbimin e Kuvendit.

(4) Me qëllim të sigurimit të mjeteve në Buxhetin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që do t'i ndahen Këshillit, Këshilli përgatit Propozimplanin financiar vjetor të sipas zërave të shpenzimeve në vitin aktual për vitin e ardhshëm dhe atë ia dorëzon Kryetarit të Kuvendit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Propozim-planin financiar vjetor Këshilli e dorëzon brenda afatit të caktuar nga Kryetari i Kuvendit.

(5) Këshilli përgatit Propozim - rregullore për mënyrën dhe kushtet për shfrytëzimin e mjeteve të parapara në Buxhetin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuara për Këshillin, të cilin e miraton Këshilli buxhetor i Kuvendit.

(6) Dokumentacioni i plotë për pagesat për nevojat e Këshillit miratohet nga kryetari i Këshillit dhe nga personi udhëheqës ose personat e autorizuar të Kuvendit, në bazë të mjeteve të siguruara në Buxhetin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuara për Këshillin për Mbikëqyrje Civile.“.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.